VENDIM
Nr. 47/2012

PËR NUMËRTIMIN E LEGJISLATURAVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Numërtimi i legjislaturave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë fillon prej Legjislaturës së Parë, e mbledhur në datën 15.4.1991, dhe vazhdon me legjislaturat pasardhëse, sipas aneksit I bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Legjislaturat parlamentare, prej krijimit të shtetit shqiptar deri në vitin 1991, renditen sipas aneksit II të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 15.11.2012